

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
“HASAN PRISHTINA”  
FAKULTETI EKONOMIK**



**LËNDA:**

**MIKROEKONOMIA**

**Kapitulli 5: Firmat**

**Asistent: Msc. Neshat PODVORICA**

**E-mail: [neshat.podvorica@uni-pr.edu](mailto:neshat.podvorica@uni-pr.edu)**

**Nëntor, 2019**

# Firmat

- Firma është një tërsi bazë që organizon dhe koordinon faktorët e prodhimit, punën, tokën, kapitalin dhe aftësin sipërmarrëse në procesin e prodhimit.
- Problemet e firmave:
  - Çfarë malli apo shërbimi të prodhojnë;
  - Çfarë teknologjie të përdorin;
  - Çfarë faktorësh të prodhimit të përdorin;
  - Çfarë strukture të udhëheqjes zgjedhin.

# Fitimi i firmës

- **Të ardhurat totale**- janë të gjitha të ardhurat që mbledhen nga shitja e mallrave apo shërbimeve.
- **Kostot totale** – janë të gjitha shpenzimet që bëhen për prodhimin e mallrave dhe shërbimeve si dhe shitjen e tyre.
- **Fitimi i firmës** – paraqet diferencën në mes të ardhurave totale dhe shpenzimeve totale.

# Cili është qëllimi i firmave?

- Qëllimi i firmave është **maksimizimi i fitimit**.
- Pra, të arrijnë fitim sa më të madh përgjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

# Koordinimi i firmave

- Nënkupton që ne e dërgojmë një makinë për ta rregulluar dhe të gjithë hapat që nga identifikimi i problemit e deri te rregullimi i tij merret firma.
- **Koordinimi i tregut-** është e kundërta.
  - Shembull: ??
- Përparësit e koordinimit të firmave janë:
  - Ekonomizimet e shkallës;
  - Skuadrat e prodhimit;
  - Kostot e transaksionit, etj.

# Llojet e firmave

- Në varësi të fushëveprimtarisë:
  - Produkteve apo shërbimeve
- Në varësi të numërit të punëtorëve:
  - Mikro, të vogla, mesme, mëdha.
- **Në bazë të ligjit 06/L-016; Neni 5:**
  - Biznes Individual, Ortakëri e Përgjithshme, Ortakëri e Kufizuar, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar ose Shoqëri aksionare
- Për nevoja të mikroekonomisë:
  - Firma individuale;
  - Firma ortakërie;
  - Koorporatat.

# Përparësit e F. Individuale

- Marrja e vendimeve vet;
- Organizohen lehtë;
- Hyjnë dalin prej degës;
- Kënaqësia që merr pronari.
- **Disavantazhet:**
  - Përgjegjësia e pakufizuar;
  - Burimet e financimit të kufizuara;
  - Varet nga jetëgjatësia e pronarit.

# Përparësit e F. me ortakëri

- Ka më shumë kapital për qarkullim;
- Aftësi organizuese më të madhe;
- Takësohen të ardhurat vetëm një herë;

## **Disavantazhet:**

- Përgjegjësia e pakufizuar;
- Kërkohet pëlqimi i të gjithë ortakëve;
- Jetë të kufizuar varet nga jeta e pronarit, etj.



# Korporatat (shoqëri aksionare)

- Kapitali i saj formohet përmes shitjes së aksioneve.
- **Aksionet** - janë letra me vlerë me të cilat tregohet që posedon një pjesë të një korporate dhe ke të drejtë të merrësh një pjesë të fitimit, që quhet dividendë.

# Përparësitë e Korporatave

- Kanë përgjegjësi të kufizuar;
- Zgjedhin bordin e drejtorëve të cilët kryejnë punën për ta;
- Kanë mundësi të shesin aksionet e tyre dhe të tërheqen nga korporata.
- **Disavantazhet:**
  - Taksohen dy herë;
  - Mund t'i bie vlera e aksioneve shumë shpejtë, etj.

# Rritja e kapitalit për Korporatat

- **Shitja e obligacioneve** – janë letra me vlerë që mbajtësit i sjellin të ardhura për çdo vit.
- Paguhet interesi i caktuar, si dhe
- Kthehet shuma totale e obligacionit të blerë
- Kemi obligacione të konvertueshme të cilat mund të shëndërrohen në aksione.

# Emetimi i aksioneve

- Kemi tre lloje të aksioneve:
  - Aksione të zakonshme;
  - Aksione të preferuara;
  - Aksionet e konvertueshme.
  
- **Kreditë bankare**

# Format e bashkimit të firmave

- **Bashkimi vertikal** – kur firma të një dege të fushave të ndryshme bashkohen. P.sh Firma për përpunimin e naftës dhe ajo që kërkon naftë.
- **Bashkimi horizontal** – firma të cilat prodhojnë të njëjtin lloj të produktit.
- **Bashkimi i firmave** (konglomerati) – Firma të ndryshme bashkëpunojnë mes veti.

# Kontabiliteti i firmës

- Bilanci i gjendjes; dhe
- Pasqyra e të ardhurave.

**Ju faleminderit!**